MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial.....

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

-
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					

Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6 .

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 7.*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)**(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)***FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT****Shërbimet që kërkohen që kërkohen:** “Shërbimi i mbajtjes nën kontroll të qenve endacake”.

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Monitorimi, kapja dhe transporti i qenve endacake	Cope	420
2	Kastrimi dhe Sterelizimi dhe Trajtimi post-operator	Cope	420
3	Matrikullimi dhe regjistrimi	Cope	420
4	Trajtimi antiparazitar	Cope	420
5	Vaksinimi	Cope	420

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Detyrat:

Shpërndarja:

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:

TERMA REFERENCE

I. Forma e realizimit të shërbimit

Trajtimi dhe menaxhimi i qenëve dhe maceve endacakë do të jetë 12 mujor/deri në ezurimin e shërbimit sipas prevntivit dhe duhet të bëhet nga një subjekt privat i cili duhet të plotësojë të gjitha standartet e kërkuara nga Bashkia Lezhë të cilat janë të bazuara në legjislacionin për vetëqeverisjen vendore dhe legjislacionin veterinar Shqipëtar në fuqi.

II. Aktivitetet të cilat do të kryhen gjatë shërbimit:

Aktivitetet që do kryhen gjatë shërbimit, konsistojnë në një sërë masash dhe veprimtarish, konform legjislacionit veterinar si dhe konformë të gjitha direktivave dhe konventave Shqipëtare dhe të Bashkimit Europian për të drejtat e kafshëve. Aktivitetet duhet të kenë në fokus kujdesin maksimal të kafshëve, si dhe të shmangin çdo formë keqtrajtimi të tyre prandaj metodat të cilat do të përdoren do të jenë të pranueshme dhe të monitoruara paraprakisht nga struktura përgjegjëse e ngarkuar nga Bashkia Lezhë për ndjekjen dhe zbatimin e kontrates.

Këto aktivitete do të jenë:

- 1- Monitorimi, kapja dhe transporti i qenve endacake,
- 2- Kastrimi dhe Sterelizimi dhe Trajtimi post-operator,
- 3- Matrikullimi dhe regjistrimi,
- 4- Trajtimi antiparazitar,
- 5- Vaksinimi,

1. MONITORIMI DHE KAPJA E QENVE ENDACAKE DHE TRANSPORTI I QENVE ENDACAKË

I. Kontraktori kryen monitorimin i cili do të jetë i vazhdueshëm dhe periodik.

Monitorimi në qytetin e Lezhës dhe Njesite Administrative Shengjin dhe Shenkoll (në këto të fundit gjatë sezonit turistik), bëhet të paktën 3 (tre) herë në javë ndërsa në njesitë e tjera administrative monitorimi bëhet të paktën 1 (një) herë në javë.

Gjatë monitorimit identifikohen zonat problematike që frekuentohen nga qenë endacake dhe bëhet plani për kapjen e tyre. Pas identifikimit të zonave problematike, kontraktori bën planin e kapjes së tyre dhe grafikun e kryerjes së kësaj shërbimi.

Kontraktori raporton çdo muaj për shërbimin e kryer tek struktura përgjegjëse e ngarkuar për ndjekjen e zbatimit të kontratës nga Bashkia Lezhë duke përcaktuar oraret dhe zonat e monitoruara si dhe grafikun e planifikimit të shërbimit të kapjes së tyre.

II. Kapja e qenëve duhet të bëhet në mënyrë të tillë që të mos shkaktojë trauma dhe strese tek kafsha, e cila gëzon një nga pesë liritë kryesore të cilët janë: liria nga uria dhe etja, liria nga paret, liria prej dhimbjes, liria prej dhunës dhe prej sëmundjes. Kapja duhet të bëhet me metoda bashkëkohore nga persona të specializuar për trajtimin e kafsheve endacakë, të cilët duhet të jenë të çertifikuar nga Urdhëri Profesional i Mjekut Veterinar Shqipëtar. Kapja duhet të bëhet nga mjek veterinar të cilët duhet të mbështeten nga punonjës me njohuri teknike (teknik të mesëm në fushën e veterinarisë), dhe trajtimi i kafsheve të bëhet me preparate mjekësore të cilat nuk shkaktojnë efekte anësore tek kafshët. Me anë të kësaj metode mënjanohet stresi ndaj kafshëve, lëndime e ndryshme si nga kafshët por edhe njerëzit të cilët i kapin.

Gjithashtu duhet të mënjanohet cdo formë dhune apo lëndime gjatë kapjes, si dhe metodat e kapjes së tyre nuk duhet të shfaqin shqetësime tek njerëzit e tjerë sidomos tek turistët. Për efekt të fluksit të qenëve duhet të ketë minimalisht dy grupe pune për kapjen e tyre dhe në përzierje të cdo grupi pune duhet të jete të paktën një mjek veterinar, pasi gjatë kapjes së tyre duhet të tregohet kujdes i veçantë sepse trajtimi i kafsheve dhe kujdesi ndaj tyre është shumë i rëndësishëm. Kapja do të bëhet pas orës 22⁰⁰ (njëzet e dy) në mbrëmje deri në orën 5⁰⁰ (pesë) të mëngjesit.

Përfshihen nga ky orar Njësia Administrative Shëngjin dhe Shënkollë gjatë përfudhës Maj - Shator si pasojë e sezonit turistik, pasi gjatë kësaj periudhe në këto zona, kapja do të bëhet nga ora 01:00 (një) deri në orën 04:00 (katër) të mëngjesit.

Kontraktori për cdo kapje do të njoftojë strukturën përgjegjëse të ngarkuar për zbatimin e kontratës nga Bashkia Lezhë. Kontraktori do të njoftojë paraprakisht në fillim të çdo muaji strukturën përgjegjëse të ngarkuar për zbatimin e kontratës nga Bashkia Lezhë në lidhje me grafikun e shërbimit, oraret, si dhe zonat ku do të bëhet kapja. Çdo kapje duhet të dokumentohet me foto e cila duhet të jete pjesë e raportit mujor dhe do të ju bashkëngjitet situacioneve të dorezuara nga kontraktori.

(Foto ilustruese mbi kapjen e qenve)

Figure 1– Skenë kapje mekanike të një qeni në Indi (Pati, 2021)



III. Transporti i qenve endacakë.

Transporti duhet të bëhet me mjete të specializuara dhe të lejuara për transportin e kafshëve nga instancat e Shërbimit Veterinar Shtetëror.

Kontraktori, i cili do të bëjë trajtimin dhe menaxhimin e qenëve endacake duhet të ketë të pakten dy mjete transporti për arsye se gjatë fluksit të verës në zonat turistike do të ketë të pakten dy grupe pune për kapjen e qenëve endacake. Mjetet e transportit duhet të kenë në brëndësi të tyre kafaze të ndara. Gjatë transportit, transportuesi duhet të ketë kujdes dhe të tregohet shumë profesional dhe i kujdeshem në mënyrë që gjatë transportit të tyre mos të ketë përplasje të kafshëve brënda kafazeve. Meqenese, për shkak të gjendjes sedative të kafshëve dhe nevojës për një vlerësim paraprak të gjendjes shëndetësore, transporti nga vendi i kapjes deri në klinike duhet të zgjasë jo më shumë se 20 (njëzet) minuta, pasi kafshet mund të pesojnë demtime gjatë kapjes apo transportimit dhe mund të nevojitet trajtim i specializuar në klinike veterinare të licensuar e pajisur me pajisjet e nevojshme për trajtimin mjekësor të tyre. Sa më sipër kontraktori duhet të disponojë të pakten një klinike veterinare të licensuar brenda territorit të Bashkisë Lezhë. Një kujdes i vecantë duhet të tregohet edhe gjatë transportit nga klinika për në destinacion të qenëve endacake pasi, në këto kushte ato janë me imunitet të dobët për shkak të trajtimit mjekësor. Në çdo rast të transportit të kafshëve nga vendi i trajtimit mjekësor për në destinacionin ku do të leshohen, mjete duhet të dezinfektohen, për shkak se nuk duhet të kalojnë sëmundjet nga qentë që kapen tek ato të trajtuar që leshohen. Rekomandohet që kontraktori të jetë i licensuar në fushën e dezinfektimit, pasi është e nevojshme dezinfektimi periodik i mjeteve dhe klinikës të cilët do të bëjnë trajtimin e qenëve endacakë. Për çdo lëshim që do të bëhet do të njoftohet struktura përgjegjëse e ngarkuar për zbatimin e kontratës nga Bashkia Lezhë. Staf i kësaj strukture merr pjesë herë pas herë gjatë lëshimit të kafshëve pas trajtimit, në territoret në të cilët ata janë kapur.

Me poshte gjeni foto ilustruese si duhet te transportohen kafshet e kapura si dhe foto te metodave te ndaluara per transportimin e tyre.

Figure 2 – Si të transportohen kafshët të kapura (Matthews, 2019)



Figure 3 – Si mos të transportohen kafshët e kapura (Farhoud, 2021)



2. KASTRIMI, STERELIZIMI DHE TRAJTIMI POST-OPERATOR

I. Kastrimi, Sterelizimi

Kastrimi dhe Sterelizimi duhet të bëhet nga klinika të licensuara. Kastrimi dhe sterelizimi duhet të bëhet 24 (njëzet e katër) orë pas kapjes, për shkak se substanca e përdorur për kapjen e tyre nganjëherë ndikon negativisht me substancat sedative të tjera.

Para operacionit kafshët duhet të lihen në vende të përshtatshme, të pastra dhe me kushte klimatike të përshtatshme. Për çdo rast duhet të bëhet trajtimi pre-operator i kafshëve dhe dieta e tyre në mënyrë që operacionet të rezultojnë me sukses maksimal. Operacioni duhet të bëhet nga mjekë veteriner profesionist, të licensuar nga Urdhri Profesional i Mjekut Veteriner Shqipëtar për ushtrimin e profesionit. Për shkak të fluksit


që mund të ketë rekomandohet që kontraktori të disponojë të paktën dy salla operatore, dhe të paktën dy mjekë veteriner, të cilët asistohen nga dy ndihmës veteriner ku të paktën njëri nga këta të ketë njohuri teknike në fushën e veterinarisë (Teknik i Mesëm Veteriner). Për trajtimet operatore mjekët veteriner profesionist mbajnë përgjegjësi për çdo operacion të cilët ato kryejnë. Operacionet duhet të dokumentojnë me foto post-operatore tek struktura përgjegjëse e ngarkuar për zbatimin e kontratës nga Bashkia Lezhë, pa cënuar të drejtat e kafshëve të cilat në gjendje sedative nuk është etike të fotografohen.

II. Trajtimi post-operator

Pas operacionit, kafshet mbahen në kujdes post operator, në vartësi të rastit nga katër deri në shtatë ditë. Trajtimi post operator konstaton me trajtimin me antibiotikë dhe kortizonikë si dhe trajtimin lokal të plagës. Në këtë periudhë duhet treguar kujdes i vecantë në akomodimin e tyre si dhe në të ushqyerin e tyre, i cili duhet të bëhet me ushqime të miratuara nga instancat shtetërore. Çdo trajtim shënohet në kartelën (regjistrin klinik) të çdo qeni në mënyrë të vecantë. Për çdo situatë e cila mund të rezultojë jashtë parashikimeve shëndetësore ato mbahen deri në trajtimin e plotë të tyre. Në asnjë moment nuk mund të zhvendosen pa u siguruar plotësisht mbi gjendjen shëndetësore të tyre.

(Foto ilustruese mbi trajtimin post operator)

Figure 6 – Trajtimi post operator



Antibiotik lokal Spray , Antibiotik Përgjithshëm në rrugë paranterale Fluidoterapi në raste të nevojshme.

3. MATRIKULLIMI DHE REGJISTRIMI


Matrikullimi dhe regjistrimi është një moment shumë serioz në strategjinë e menagjimit të qenve endacake. Matrikullimi bëhet me matrikuj të posaçëm për qentë endacakë. Matrikullimi konstaton në identifikimin e qenëve pas trajtimit duke u ndjerë të sigurtë për punën e kryer dhe në mënyrë që të mos i kapim disa herë. Çdo qen pajiset me një kartelë të posaçme mjekësore e cila identifikohet në bazë të matrikullit dhe shënohet detaj për detaj çdo trajtim i tyre nga kapja e deri në lëshimin e tyre në vendin ku ata janë marrë. Çdo matrikullim shënohet në kartelë dhe çdo shënim në kartelë i bashkëngjitet raportit mujor që dorëzon kontraktori pranë struktura përgjegjëse e ngarkuar për zbatimin e kontratës nga Bashkia Lezhë.

(Foto ilustruese të qeneve pa matrikull dhe të matrikulluar)

Figure 4 – Qentë në Lezhë pa matrikull
(Panorama.al, August 2018)



Figure 5 – Qen i matrikulluar (Kwan, 2018)



4. TRAJTIMI ANTIPARAZITAR

Pas trajtimit post operatorë, bëhet trajtimi me antiparazitarë të brëndshëm dhe të jashtëm. Antiparazitët duhet të jenë liçensuar dhe me efikasitet të plotë për të gjithë llojet e parazitëve. Cdo trajtim i përdorur shënohet në kartelën shëndetësore duke e shoqëruar dhe me stampën e produktit i cili duhet të tregojë numrin serial, numrin e lotit dhe datën e skadencës së produktit. Ky veprim ka rendësi të jashtëzakonshëm profilaktik dhe mjekësor për kafshën. Gjithashtu është shumë e rëndësishme për mbikëqyrjen e shëndetit human duke qenë se shumë parazita kanë si bujtës njeriun dhe mund të transmetohen nga qeni/mace te njeriu dhe shumë nga këto parazita janë vector sëmundjesh.

(foto ilustruese ne lidhje me parazitet)

Figure 7 – Disa parazita gjakthithës të përbashkët (rriqëra dhe mushkonja)



5. VAKSINIMI

Pasi qentë endacakë të jenë të shëndetshëm plotësisht ata bëhen gati për lëshim dhe në këto momente vaksinohen me vaksinën e tërbimit. Vaksina duhet të jetë e regjistruar në regjistrin kombëtar të barërave në Ministrinë e Bujqësisë. Cdo vaksinim shënohet në kartelën shëndetësore duke e shoqëruar dhe me stampën e produktit i cili duhet të tregojë numrin serial, numrin e lotit dhe datën e skadencës së produktit. Vaksina duhet të bëhet dhe të injektohet kur qentë të jenë totalisht të shëndetshme pasi ne rast te kundert, sëmundja mund të agravohet ose vaksina nuk mund të jetë efektive.

(foto ilustruese per vaksinimin)

Figure 8 – Biocan R® Vaksinim



Kontraktori gjate kryerjes se sherbimit administron dokumentacionin ne lidhje me ilaqet, vaksinat apo cdo mjet tjeter te perdorur gjate sherbimit si dhe foto te gjithe procesit te mesiperme, te cilat i bashkengjiten raportit mujor qe dorezohet prane prane struktures pergjegjese te ngarkuar per zbatimin e kontrates nga Bashkia Lezhë.

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Kjo pikë e kriterëve plotësohet me Kriteret e përgjithshme të pranimit/ vecanta të kualifikimit të plotësuar më sipër. (Shtojcat).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument që vërteton se subjekti i ka plotësuar të gjitha detyrimet e maturuara të taksave dhe tarifave vendore, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

Shenim: Kjo kërkesë permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Këto shërbime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a-Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara dhe të deklaruara në organet tatimore.

ose

b-Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me license për Klinike Veterinare me kod II.2.C. Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqesë licensën me kodin II.2.C për Klinike Veterinare.

2.3.3 Operatori ekonomike ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 3 (tre) punonjës për periudhën Qershor 2026 – Gusht 2026, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Qershor 2026 – Gusht 2026.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Qershor 2026 – Gusht 2026.

Shenim: Kjo kërkesë permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit permbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit.

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar staf si më poshtë:

a- Të paktën 1 (një) mjek veterinar (i pajisur me Diplome Universitare dhe license nga Urdhri Profesional i Mjekut Veterinar Shqipëtar për ushtrimin e profesionit.).

b- Të paktën 1 (një) ndihmes veterinar (i pajisur me Diplome të Shkolles së Mesme në fushën e veterinarisë).

c- Të paktën 1 (një) punonjës nga stafi teknik ose mbështetës duhet të jetë çertifikuar nga Urdhëri Profesional i Mjekut Veterinar Shqipëtar për trajtimin e kafsheve endacake. (Çertifikatë trajnimi).

Per plotesimin e ketij kriteri OE-te duhet te paraqesin: Diplomat, Licensen nga Urdhri Profesional i Mjekut Veteriner Shqipëtar për ushtrimin e profesionit, Kontratat e punës dhe Certifikatat e trajnimit sipas shenimeve te mesiperme, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën për periudhën Qershor 2026 – Gusht 2026.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

2.3.5 OE duhet të disponoje në pronësi, me qira ose kontrate bashkepunimi nje automjet te licensuar per transportin e kafshëve te leshuara nga strukturat e Shërbimit Veterinar Shtetëror.

Per kete duhet te paraqesë:

- Ne rast te disponimit te automjetit ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit: - çertifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore si dhe licensen per transportin e kafshëve te leshuara nga Shërbimi Veterinar Shtetëror.
- Ndersa per mjete te marra me qira/kontrate bashkepunimi krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qirase/ bashkëpunimit.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Informacione për nënkontraktorin
--

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarimenëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet nevojshme</i>_____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
